

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 27 JANAR 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Sot kemi në dorë një nismë, e cila ka të bëjë me fiskalizimin. Dëgjuam me durim një patetizëm pafund për luftën ndaj informalitetit, gjithashtu dëgjuam të flitej në emër të qytetarëve, u përmend që ligji është konsultuar edhe me grupet e interesit, por nuk dëgjova asnjë të përmendte që biznesi i vogël ka bërë një grevë të madhe më 31 tetor dhe vazhdon të jetë një shqetësim i jashtëzakonshëm, që ka të bëjë me mbijetesën e këtij biznesi, ka të bëjë me 360 deri në 400 mijë qytetarë. Fjala “Biznesi i vogël” është përdorur vetëm sa i takon terminologjisë fiskale. Të gjithë e dinë që nuk është biznesi i vogël, por janë aktivitete mbijetese. Shteti çdo të enjte prodhon vetëm mynxyrë për qytetarët, dënime, gjoba. Ndërkohë që këta qytetarë të varfër dënohen me gjoba, ata që janë në kërkim për inceneratorët vazhdojnë të paguhen me miliona. A na i shpjegojnë dot si është e mundur që pronarët, që janë në kërkim ndërkombëtar, vazhdojnë të paguhen rregullisht?! Për çfarë paguhen rregullisht?! Për të mbyllur gojën, që të mos ndihen, të vazhdojnë të fshihen, të mos i prishin terezinë njeriut?! Për çfarë?! Pra, atij që shet dy pako biskota i kërkohet llogari një më një dhe do të dënohet me gjobë, ndërsa atyre që janë në kërkim ndërkombëtar sot e kësaj dite u paguhen miliona. Po kështu, këtyre bizneseve të vogla u kërkohet çdo qindarkë, ndërkohë që sot, në një nga pikat e rendit të ditës, kërkohet të merret një hua tjetër prej 50 milionë eurosh sa i takon sektorit të energjisë, pa thënë gjekundi një fjalë se çfarë u bë me 200 milionët që u morën në nëntor (ende nuk janë bërë dy muaj). Pra, ngrihet një piramidë gjigante borxhesh, e cila është kryekëput korruptive, është vetëm një transfuzion në venat e korrupsionit, por jo në venat e ekonomisë, dhe nuk ndodh asgjë.

Ndërkohë, këtu ulërihet për fiskalizimin e jashtëzakonshëm, në kushtet e një privatizimi primitiv, procese që do të jenë të elektronizuara, ndërsa faqja e Qendrës Kombëtare të Biznesit ka javë që nuk aksesoret. Pra, do të aksesohet në pjesën e zonës rurale më të varfër dhe ai që shet në atë dyqanin e vogël të fshatit do të bëjë fiskalizimin perfekt, se në rast të kundërt do të dënohet! Një butafori vërtet e neveritshme! Flitet në emër të të gjithëve, por edhe vota do të ngrihet në emër të të gjithëve. E çfarë vote do të ngrihet? Një votë kundër e atyre 400 mijë njerëzve, që thjesht dhe vetëm mbijetojnë, votë e cila do t’u rëndojë çdo vit shpenzimet, në atë fitim aq të paktë me të cilin mbajnë familjet e tyre, punësohet edhe një rreth familjar, për të cilët nuk ka asnjë vëmendje dhe nuk ekziston fare shteti për ta. Nëse këta nesër e mbyllin këtë biznes, se nuk e mbajnë dot në këmbë, çfarë do të ndodhë? Zëre se janë njerëz në mes të 4 rrugëve, ku si alternativë të vetme të tyre kanë vetëm largimin nga Shqipëria. Sigurisht, asnjë nuk shqetësohet, se çdo biznesi i vogël që mbyllet ata qytetarë që e kishte klientë do të shkojnë te bizneset e mëdha të oligarkëve.

Pra, dihet se kush janë të kënaqurit. Është shumë e qartë se në një periudhë të tillë, ku ka merak të jashtëzakonshëm për të dënuar atë që është shumë i varfër, asnjë nuk e përmend se cila është ndihma që u jepet këtyre të varfërve. Mirë që i dënoni, po mbështetja ku është? Janë mijëra e mijëra, minimumi 110 mijë raste janë nga pandemia, por rastet e vërteta janë shumë më tepër. Cila është ndihma shtetërore që u jepet? Vetëm për të regjistruarit duhet të ishin shpenzuar rreth 15-20 milionë euro ndihmë, ndërkohë që s’ka asnjë lekë. E, mandej, flitet në emër të qytetarëve këtu dhe

vazhdimisht dëgjojmë këtë demagogji. Mirë, le të gënjejnë veten e tyre, por nuk mund të na gënjejnë të gjithëve, pa përjashtim, se faktet flasin dhe janë kaq kokëforta dhe të qarta, janë kaq në dritën e diellit, saqë nuk i fsheh dot njeri. Si do t'ua përkthejnë shqiptarëve që kanë marrë 700 e ca milionë euro, po marrin edhe 50 të tjera, marrin, marrin, e në fund fare nuk ndryshon asgjë! Asgjë nuk ndryshon. Sigurisht, një grup i vogël pasurohen, e po i njëjti grup flet në emër të të gjithë këtyre njerëzve, të cilët dënohen, sakatohen dhe nuk gjejnë në Shqipëri asnjë arsye për të jetuar, se nuk kanë mundësi të mbijetojnë. Praktikisht, sot po goditet biznesi i vogël, i cili sot e kësaj dite e thotë qartë dhe haptazi se nuk mund ta përballojnë këtë gjë dhe vetë shteti nuk është i përgatitur teknikisht. Megjithatë nuk është i përgatitur teknikisht, është aq shtet i lig sa të gjithë atë kundërvajtje, atë pamundësi t'ia përkthejë në faj atij tjetrit, që ai të jetë i varur nga shteti, e kur të vijë momenti elektoral të bëjë sikur shteti i fal ndonjë gjë, që ta shohin në dritë të syrit atë që të fal, të dënon, të fal shpirtin dhe ta merr shpirtin.

Kjo është një poshtërsi e madhe, pasi qytetari, qoftë ai që merret me biznes, apo tjetër, ka një raport vetëm me ligjin: ose është në rregull, ose nuk është. Ligji duhet të jetë i drejtë dhe i realizueshëm. Grupet e interesit për këtë parlament nuk ekzistojnë, kanë vdekur, nuk duhet të dëgjohen, duhet të dëgjohej vetëm urdhri i qeverisë. Vetë ekspertët e ekonomisë citojnë se është ende e parakohshme për këto kushte në të cilat ndodhet Shqipëria, por këta thonë: "S'ka gjë për ata, po s'ka gjë as për 400 mijë qytetarë, s'ka gjë as për grupet e interesit, s'ka gjë për këtë, s'ka gjë për atë", por ka gjë vetëm për këta. A shkon kjo për ata që na dëgjojnë?! Profesionistët nuk dëgjohen, mijëra hallexhinj nuk dëgjohen, po kush dëgjohen? Dëgjohen vetëm këta të! Pra, do të thotë se dëgjohej një pakicë e vendosur para një shumice absolute, interesat e të cilëve jo vetëm që nuk i garantojnë, por po i dëmtojnë në mënyrë të vazhdueshme me një strategji dhe një mënyrë të caktuar. Kush është bashkë me ta? Është edhe një grup i vogël klientësh, të cilët, ashtu si parimi i enëve komunikuese, mbajnë njëri-tjetrin, dhe sigurisht që janë të lumtura të dyja palët. Po kaq janë, janë vetëm një grup. Atje është një masë e madhe, e cila diskriminohet dhe që humbet arsyen për të jetuar në këtë vend. E parë në të gjithë gjerësinë e vet, është e qartë që, në fund të fundit, e gjithë kjo politikë ka prodhuar vetëm një tregues: një korrupsion dhe kriminalitet që vetëm thellohet. Flasin për reformat, edhe sot dëgjuam që do të fusin disa reforma të tjera gjoja për kontrollin e pastrimit të parave. Po ç'pastrim parash do të kontrollojnë këta? Qindra kulla që janë aty në mes të sheshit pastrojnë para dhe bëjnë sikur do të kontrollojnë paratë me atë vetingun e noterëve, që do ta bëjë ministri, nuk do ta bëjë një trupë e pavarur, siç me demokritet flitet për vetingun, por do ta bëjë ministri. Absolutisht asgjë! Pushteti ka vetëm një kuptim, centralizimi në një dorë, mbajtja aty dhe çdo gjë të jetë në varësi të tij, që të shkosh ta shohësh ministrin apo qeveritarin në sy, se ky ta jep shpirtin, e ky ta merr. Këto janë të vërtetat që janë shkruar atje! Në rast se të gjitha këto hapa të hedhur do të kishin një gram rezultat, atëherë pse Shqipëria është e dyta në botë për korrupsion? Jo më larg se dy ditë më parë ka pasur rënie të njëpasnjëshme, njëpasnjëshme. Çfarë tregon kjo? Kjo tregon qartë vullnetin: ose e lufton korrupsionin dhe ke vullnet, ose nuk ke. Këta marrin masa gjoja fiktive dhe ligje të shkruara që me demokritet luftojnë korrupsionin, por korrupsioni thellohet. Pse ishte më i ulët më parë? Sepse është çështje vullneti. Nëse do, e zbaton me konsekuencë ligjin dhe nuk i hap rrugë korrupsionit. Shkruaji ligjet si të duash, kur nuk do t'i shohësh me sy, bën veçse të mbeten në letër!

Pra, e gjithë kjo gjë që po luhet këtu është një farsë, e cila fillim e mbarim u bie mbi kokë vetëm njerëzve të varfër, njerëzve të thjeshtë dhe ua bën të pamundur jetesën në Shqipëri. Është shumë e qartë që qeveria ka vetëm një qëllim: t'ua bëjë jetesën të pamundur, Shqipëria aktive të jetë sa më e paktë, të largohet nga vendi, në mënyrë që ajo të mos ketë shqetësim për të vazhduar të qeverisë dhe të mbajë me dhëmb një pushtet kriminal, korruptiv, i cili vetëm e rrënon në mënyrë të vazhdueshme këtë vend. Natyrshëm, këto nisma absolutisht që nuk mund të votohen dhe do të votohen kundër,

por, mbi të gjitha, ndjeshmëria duhet të jetë maksimale për të kuptuar që ky vend po rrënohet pa kthim. Faleminderit!